


Problema me 3 pikë

1. Sa rrethë janë vizatuar në figurë?


- (A) 5 (B) 6
(C) 7 (D) 8
(E) 9



2. Në të djathtë është paraqitur pamja nga përpara e 5 kubeve.

Si do të duken ato nga sipër?


- (A) (B) (C) (D) (E)



3. Në secilin nga tasat e mëposhtëm ndodhen katër topa me numra. Cili është tasi që ka shumën më të madhe të numrave?

- (A) (B) (C) (D) (E)

4. Një katror është ndarë në disa pjesë (figura majtas). Skënderi i rivendosi këto pjesë për të formuar figurën e kangurit (djathtas).



Cilën pjesë nuk përdori Skënderi?

- (A) (B) (C) (D) (E)

5. Varka ime ka më shumë se 1 rreth. Ajo gjithashtu ka 2 trekëndësha më shumë se katrorë. Cila është varka ime?


- (A) (B) (C) (D) (E)

6. Kjo është torta e ditëlindjes së gjyshit tim. Një qiri i madh tregon 10 vjet dhe një i vogël tregon 1 vit. Sa vjeç është gjyshi im?

- (A) 65 (B) 66
(C) 76 (D) 77
(E) 78




7. Agroni vendosi 10 makina lodrash në këtë pistë garash. Sa makina ndodhen në tunel?



- (A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 8 (E) 9

8. Sokoli udhëton nga pika X në Y. Në çdo kryqëzim, ai ndalon përpara se të vazhdojë rrugën drejt përpara, pa u kthyer. Në tërësi, sa herë ndalon Sokoli përpara një kryqëzimi?


- (A) 11 (B) 12 (C) 13
(D) 14 (E) 15



Problema me 4 pikë


9. Një park ka 5 pemë. Një kastor mund të shohë vetëm dy nga pemët, sepse të gjitha pemët e tjera janë të fshehura. Në cilën nga pikat e shënuara në figurë qëndron kastori?

- (A) në A (B) në B
(C) në C (D) në D
(E) në E



10. Në figurë janë 24 katrorë. Zana ka ngjyrosur disa nga katrorët. Edhe sa katrorë të tjerë duhet të ngjyrosen në mënyrë që të jenë ngjyrosur gjysma e katrorëve?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3
(D) 4 (E) 5




11. Dy shenjat e pikëpyetjes tregojnë të njëjtin numër. Cili është ky numër që mundon në mënyrë që shuma të jetë 18?

$$\textcircled{10} + \textcircled{?} + \textcircled{?} + \textcircled{2} = 18$$

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

12. Rajmonda dëshiron të përfundojë vizatimin e bletës në të majtë sipas modelit në të djathtë.



Për çdo pjesë që duhet të vizatojë asaj i nevojiten aq pikë sa tregon numri në të djathtë të pjesës. Sa pikë duhet të fitojë Rajmonda që të përfundojë bletën?


- (A) 9 (B) 10 (C) 11 (D) 12 (E) 13

13. Tabela ka 30 kuti. Pasi të jenë lyer kutitë në rreshtin 3, rreshtin 6, shtyllën C dhe shtyllën D, sa kuti do të kenë mbetur pa u lyer?

	A	B	C	D	E
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- (A) 8 (B) 10 (C) 12 (D) 18 (E) 22


14. Një fletë letre paloset sipas vijës së ndërprerë të treguar në figurë. Pas palosjes asaj i hapet një vrimë katrore dhe një vrimë e rrumbullakët (si në figurë).



Si do të duket fleta pasi të shpaloset sërish?



- (A) (B) (C) (D) (E)

15. Një nxënës formoi trupin që tregohet në figurë duke përdorur 12 kube. Ai vendosi një pikë ngjitëse ndërmjet faqeve të përbashkëta të dy kubeve fqinje. Sa pika ngjitëse përdori ai?



- (A) 8 (B) 9 (C) 10
(D) 11 (E) 12

16. Maksi dëshiron të plotësojë pazëllin në të majtë. Për këtë ai ka këto 5 pjesë të ndryshme.




Cilën nga treshet e mëposhtme duhet të përdorë ai për të plotësuar pazëllin?

- (A) (B) (C)
(D) (E)

Problema me 5 pikë

17. Elvisi ka 6 trekëndësha të njëjtë si ky




. Cilën nga figurat e mëposhtme mund të formojë ai?

- (A) (B) (C)
(D) (E)

18. Pesë fëmijë, Aliu, Lea, Luani, Saranda dhe Viktori, kanë ditëlindjen në të njëjtën ditë dhe secili fëmijë ka tortën e vet. Lea është dy vite më e madhe se Luani, por një vit më e vogël se Aliu. Viktori është më i vogli. Cila nga tortat e mëposhtme është torta e Sarandës?



- (A) (B) (C) (D) (E)

19. Harta tregon pesë fshatra A, B, C, D dhe E, si dhe largësitë në kilometra ndërmjet tyre. Vetëm dy fshatra jo fqinjë janë në të njëjtën distancë nga njëri-tjetri, pavarësisht nga rruga që zgjidhet. Cilat janë këto dy fshatra?



- (A) B dhe E (B) B dhe D
 (C) C dhe E (D) A dhe C
 (E) A dhe D

20. Semi ecën nëpër një labirint dykatësh nga hyrja në dalje, të dyja të vendosura në katin 1 (shihni figurat). Në cilën radhë do t'i ndeshë ai pikturat e ngjitura në mure?



- (A) 🐷 🐮 🐟 (B) 🐟 🐮 🐷 (C) 🐮 🐟 🐷 (D) 🐮 🐷 🐟 (E) 🐟 🐷 🐮

21. Ema u rendit e treta në një konkurs vallëzimi solo. Mes saj dhe vendit të fundit ishin tre kërcimtarë. Sa valltarë morën pjesë në këtë konkurs?

- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

22. Ermali vendosi njerën nga pesë format e mëposhtme mbi tabelë. Ai nuk mund as ta rrotullojë dhe as ta kthejë përmbys formën.

1	6	7
9	5	4
2	8	3


Cilën formë duhet të përdorë ai që të mbulojë numrat me shumën më të madhe?

- (A) (B) (C) (D) (E)

23. Në një pellg jetonin tre bretkosa. Çdo natë, një nga bretkosat u këndonte një këngë dy të tjerave. Pas 9 netësh, njëra nga bretkosat kishte kënduar 2 herë. Një bretkosë tjetër kishte dëgjuar 5 këngë. Sa këngë ka dëgjuar bretkosa e tretë?

- (A) 7 (B) 6 (C) 5 (D) 4 (E) 3

24. Shifrat 1, 1, 2 dhe 3 janë shtypur në katër letra të ndryshme. Prej tyre janë zgjedhur 3 për të bërë një zbritje, siç tregohet në figurë. Sa rezultate të ndryshme merren?



- (A) 6 (B) 8 (C) 10 (D) 12 (E) 24